

## **Punëtori tematike “Krijimi i programit për punë të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në komunën e Çashkës për vitin 2008”**

Më 22 shkurt të vitit 2008 në Çashka u mbajt punëtorja e parë në kuadër të punëtorive tematike të parapara me projektin “Jetesa në mjedis multietnik – qytetarë me të drejta, mundësi dhe mbrojtje të njëjtë”. Në punëtori morën pjesë 23 pjesëmarrës, mes të cilëve 5 përfaqësues nga shkollat fillore në Çashkë dhe Bogomillë, 5 përfaqësues nga Komuna e Çashkës, 6 anëtarë të Këshillit të Komunës, 3 anëtarë të monitorimit lokal dhe 4 përfaqësues nga OJQ-t e Velesit. Kjo punëtori tematike u identifikua si nevojë nga ana e përfaqësuesve të sektorit qytetar, bashkësive lokale dhe pushtetit lokal në komunën e Çashkës me qëllim të avancimit të punës së Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive. Punëtorinë e modeloi Biljana Manaskova – referent i pavarur për arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe barazi gjinore pranë Komunës së Velesit. Jusuf Ahmedov, kryetar i Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në Çashkë, në fillim e prezantoi propozimin e Komisionit për vitin 2008 ku parashihen 50,000.00 denarë nga buxheti i Komunës. Njëkohësisht theksoi se në përbërjen e Komisionit marrin pjesë përfaqësues nga të gjitha bashkësitë që jetojnë në territorin e Komunës Çashka (Maqedonas, Shqiptar, Turk, Serb dhe Boshnjak). Mungesa e medimeve lokale në Çashkë u identifikua si një nga mungesat më të mëdha për shkak se nuk ekziston mbulesë mediale e aktiviteteve, kurse shtëpitë nacionale mediatike nuk kanë interes. Kryetarja e Komisionit për mundësi të barabarta të meshkujve dhe grave nga Velesi, Stojna Trajkovska diskutoi për punën e këtij komisioni, si dhe për mundësitë për bashkëpunim dhe pikët e përbashkëta të dy komisioneve.

Diskutimi për aktivitetet e mundshme në të ardhmen u zhvillua kur pjesëmarrësit i identifikuan nevojat dhe prioritetet nëpërmjet punës në grupe, edhe atë: ngritja e vetëdijes publike për përparësitë e jetesës multietnike nëpërmjet njoftimit të ndërsjellë dhe krenimit të ditëve që bashkojnë, përfshirjen e vajzave në proceset arsimore, përmirësimi i infrastrukturës, angazhimi më i madh i grave myslimane në jetën shoqërore, punë më transparente me buxhetin e komunës, kyçje më e madhe e medimeve, përfaqësim i drejtë i bashkësive etnike në institucione, formimi i organizatës joqeveritare në komunën e Çashkës dhe zhvillimi i turizmit rural.

Në kuadër të punëtorisë, anëtarët e Komisionit i pranuan propozimet e pjesëmarrësve duke siguruar pjesëmarrje aktive të qytetarëve në krijimin e programit. Të pranishmit u informuan se ajo që është përpiluar në formë të shkruar do të dorëzohet Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në Komunën e Çashkës si propozim për plotësimin e propozimit të Komisionit.

Aktivitetet e propozuara në programin vjetor janë si një vijim: organizimi i manifestimeve kulturore, organizimi i lojërave në futboll të vogël, krenimi i datave të rëndësishme, organizimi i forumeve, tribunave, punëtorive, takime më të shpeshta me bashkësitë lokale dhe bashkëpunim më i madh me organizatat joqeveritare, popullarizimi i arsimit, lobim në shkollat për kyçjen e të gjitha bashkësive në arsimin formal dhe joformal, kyçjen e gruas myslimane në strukturat e ndryshme drejtuese. Vëmendje e posaçme duhet ti kushtohet bashkëpunimit me medimet nacionale për afirmimin e rolit të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive.

Këshilli i Komunës së Çashkës në muajin mars të vitit 2008 e pranoi Programin e propozuar për punë të Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në vitin 2008 duke i pranuar aktivitetet e propozuara të dala nga punëtorja tematike me çka komuna e rriti buxhetin për aktivitetet e komisionit në 80,000.00 denarë.